

STATUTI I
SHOQERISE TREGTARE
“BUILDING 2019” SH.P.K.

Kreu 1
Dizpozita te pergjithshme

Neni 1

Sipas kerkesave te ligjit numer 9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” dhe atij numer 9723, date 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, krijohet shoqeria tregtare “BUILDING 2019” Sh.p.k , e cila do te veproje ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe nenet e ketij statuti.

Neni 2

Ne kete statut termat e meposhtme kane keto kuptime:

Statuti: Statuti i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar “BUILDING 2019” Shpk.

Shoqeria: Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar “BUILDING 2019” Shpk.

Ligi Tregtar: Ligi 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

Në kuptim të këtij statuti, shprehjet në njëjës përfshijnë ato në shumës dhe anasjelltas me përashtim të rastit kur sipas konteksit të dispozitës rezulton ndryshe. Përemri vtor “ai” përfshin edhe përemrin vtor “ajo” dhe përemrin vtor “atë”, nënkuftohen të dyja gjinitë me përashtim te rasteve kur sipas konteksit të dispozitës rezulton ndryshe.

Të gjitha njoftimet, kërkesat ose komunikimet e tjera që shoqëria i drejton ortakëve sipas këtij statuti, do të bëhen me shkrim dhe do të konsiderohen se janë kryer në mënyrë të rregullt kur dërgohen ortakëve në adresat e deklaruara prej tyre pranë administratorit të shoqerisë.

Kreu 2
Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia

Neni 3

Sot, me 25.03.2019, une, ortaku themelues, kam krijuar një shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin BUILDING 2019 Sh.p.k.

Themelues i shoqerise “BUILDING 2019” Shpk eshte:

- Z. Gaetano Giovannetti, i datelindjes 22.07.1950, i biri Vittorio, lindur ne Itali dhe banues ne Via Orio Vergani N.15, LT.4 PL.G SC.G, PL.7, Roma, Itali, i pajisur me karte identiteti italiane me nr. AX2868077.



Neni 4

Shoqeria do te kete statutin e nje shoqerie me perjegjesi te kufizuar.

Neni 5

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jetet:

1. Manaxhim financiar, imobiliar dhe tregtar.
2. Te marre pjese ne tendera dhe koncesione, per vete dhe per te trete, per punime ne ndertime civile dhe industriale, tradicionale, restaurime te ndertesave monumentale, punime dhe germime arkeologjike. Ndërtimtare dhe montime te llojeve te ndryshme, i sistemeve te brendshme dhe te jashtme, i dritareve, lyrje, instalime te ndryshme etj.
3. Ndertime dhe mirembajtje te ndryshme rrugore, aeroportuale, portuale, hekurudhore, duke përshtire shenjat dhe facilitetet per sigurine rrugore, tubacioneve te gazit, tubacione te ujave, impiante te trajtimit te ujit te pijsphem, i digave, i galerive, trajtimi i mbeturinave bimore, etj.
4. Rilevime te ndryshme topografike dhe eksplorimi i nentokes me mjete te specializuara, shpimi i puseve, hidroizolim i terreneve dhe veprave te ndryshme ne nentoken Shqiptare dhe jo vetem.
5. Shitblerje, menaxhim dhe dhenie me qera te pasurive te paluajtshme.
6. Import-Eksport, tregti me shumicë dhe pakicë e të gjitha produkteve, pajisjeve dhe shërbimeve për ndërtimtare civile dhe industriale, si: pjesët e drurit, pajisje per kopshte, parkete, pajisje elektrike, kondicionere, elektroshtepiak, pajisje per mobilime te brendshme dhe te jashtme, makinerite dhe pajisjet e nevojshme per to.
7. Te kryeje cdo aktivitet ne perputhje me legjisacionin e Republikes se Shqiperise, te marre pjese ne interesa dhe aksione te shoqerive tregtare direkt dhe indirekt, te marre financime te cdo lloji dhe te lere garanci te cdo lloji, per detyrimet te veta dhe per detyrimet te te treteve, deri ne kufirin ku keto pjesemarrje influencojne ne objektin e veprimtarise se shoqerise ose dalin kunder legjisacionit te republikes se Shqiperise.

Neni 6

Shoqeria e ka seline e saj ne:

Rr. "Rrapo Hekali", (prane qendres Eleonore), Nr.Pasurie 109/24, në Zonën Kadastrale 3292, kati i dyte, zyra nr. 6, Selitë, Tirana.

Ajo mund te cele dhe adresa aktiviteti te tjera te dyta, dege e filiale ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise si dhe jashte saj.

Neni 7

Shoqeria do te kete kohezgjatjen e veprimtarise se saj pa afat.

Neni 8

Shoqeria ka vulen e saj.

Kreu 3 **Kapitali**

Neni 9

Kapitali themeltar fillestari i shoqerise eshte 5.000.000 (Pese milion) leke dhe perbehet nga 1(nje) kuote. Pjesemarrja e ortakeve themelues ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme:

- Z. Gaetano Giovannetti, i datelindjes 22.07.1950, i biri Vittorio, lindur ne Itali dhe banues ne Via Orio Vergani N.15, LT.4 PL.G SC.G, PL.7, Rome, Itali, i pajisur me karte identiteti italiane me nr. AX2868077, zoterues i 1 (nje) kuote me vlore te pergjithshme 5.000.000 leke qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Te gjitha kuotat e kapitalit themeltar do te shlyhen me afat deri ne 2 vjet. Kontributi i ortakeve mund te jete ne para ose ne natyre.

Neni 10

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet ose te zvogelohet sipas vendimit te ortakeve. Ne asnjë rast shumica nuk mund te detyroje një ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendime ne te njejtat kushte qe kerkohet per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit i prek ortaket ne te njeften mase ndaj pjesave te kapitalit qe perfaqesojne.

Neni 11

Ortaku mund te transferoje te treteve kuotat e tij te kapitalit pjeserisht ose teresisht. Transferimi i kuotave tek te tretet do te behet vetem pasi te kete marre vendim asambleja e ortakeve me shumice absolute te votave.

Kuotat e kapitalit mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise.
- b) Shitblerjes.
- c) Trashegimise.
- d) Dhurimit.
- e) Cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Kreu 4 **Organet vendimmarrese dhe drejtuese**

Neni 12

Organet te shoqerise do te jene:

- Asambleja e ortakeve.
- Administratori.

Fusha e veprimit, perberja dhe menyra e funksionimit te organeve drejtuese rregullohet si me poshte.

Asambleja e ortakeve

Neni 13

Asambleja e ortakeve eshte organi me i larte vendimor.

Asambleja e ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e ortakeve merr vendime sa here e sheh te arsyeshme, por domosdoshmerisht per te miratuar pasqyrat financiare vjetore te shoqerise.

Neni 14

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:

- a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) Ndryshimet e statutit;
- c) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- ç) Emërimin dhe shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore, shperndarjen e fitimeve dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) Rior organizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) Miratimin e rregullave proçeduriale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Neni 15

Asambleja e përgjithshme thirret nepermjet një njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike te ortakeve. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Kur asambleja e përgjithshme nuk eshte thirrur sipas paragrafit te mesiperm te ketij nen, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht kesaj parregullsie.

Neni 16

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne një shumice te zakonshme, asambleja e përgjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30% te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e përgjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, ajo mund te marre

vendime te vlefshme, vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht.

Nese asambleja e per gjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumi te permendor me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

Neni 17

Asambleja e per gjithshme vendos me tri te katertat ($\frac{3}{4}$) e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per:

- a) Ndryshimin e statutit,
- b) Zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar,
- c) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore
- ç) Shperndarjen e fitimeve,
- d) Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e per gjithshme vendos me shumice te votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtje te tjera si:

- a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) Emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - c) Emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) Përcaktimin e shpërblimeve;
 - d) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshire përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - dh) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - e) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet ne QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Administrimi

Neni 18

Asambleja e per gjithshme emeron nje ose me shume persona si administrator te shoqerise. Afati i emerimit eshte 5 vjet, me te drejte riperteritje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne QKB.

Neni 19

Administratori ka te drejte te perfaqesoj shoqerine ne maredhenie me te tretet per permbushjen e aktivitetit te saj ne perputhje me nenin 5 te ketij statuti.

Organzi Administrativ (administratori) ka te drejte dhe duhet te:

- a) Kryeje me mirebesim të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e per gjithshme e ortakeve e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi;
- b) Përfaqësoje shoqërinë tregtare;
- c) Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) Përgatit dhe nënshkruaj pasqyrat financiare vjetore, dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shperndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së per gjithshme pér miratim;



- d) Krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - dh) Kryej regjistrimet dhe të dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - e) Raportojë përrapa asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - ë) Kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
 - f) Marrë në punë persona të ndryshëm dhe rregullimin e marrëdhënieve të punës me ta.
 - g) Përfaqesojë apo emërojë përfaqësues në çështje gjyqësore që mund të ketë shoqëria ose në çështje të tjera me palë të treta;
- Nese asambleja e per gjithshme emeron me shume se një administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine, pavec rasteve kur ne vendimin e emerimit shprehet ndryshe.
- Asambleja e per gjithshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme.

Neni 20

Administrator i shoqerise "BUILDING 2019" shpk emerohet:

1. Z. Gaetano Giovannetti, i datelindjes 22.07.1950, i biri Vittorio, lindur ne Itali dhe banues ne Via Orio Vergani N.15, LT.4 PL.G SC.G, PL.7, Rome, Itali, i pajisur me karte identiteti italiane me nr. AX2868077. Afati i mandatit te administratorit do te jete 5 vjet nga data e miratimit te ketij statuti.

Kreu 5

Kushtet ekonomike

Neni 21

Shoqeria eshte pronare, disponuese dhe perdoruese e pasurise se saj. Ajo vepron ne regjistrin e prones si cdo person tjeter juridik ne Shqiperi, mund te bleje, te shese, te jape ne perdomim, etj.

Neni 22

Ne fund te cdo periudhe ushtrimore hartohen pasqyrat financiare sipas ligjeve ne fuqi. Pasqyrat financiare periodike mujore, tremujore, gjashtemujore miratohen e nenshkruhen nga administratori i shoqerise. Pasqyrat financiare vjetore nenshkruhen nga administratori dhe miratohen nga Asambleja e per gjithshme e Ortakeve.

Neni 23

Viti finanziar i shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit ne QKB dhe mbylltet me 31 Dhjetor.

Neni 24

Marredheniet e punes ne kete shoqeri rregullohen nepermjet kontrates se punes. Per ceshtjet qe nuk parashikohen ne kete statut do zbatohen dispozitat e Kodit te Punes ne Republiken e Shqiperise. Mosmarreveshjet e punonjesve me shoqerine do te zgjidhen ne gjykaten shqiptare.

Kreu 6

Dispozita te vecanta

Prishja – Rioranizimi i Shoqerise

Neni 25

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe, per shkaqet:

- a) Me vendim te Asamblese se Ortakeve per prishjen e shoqerise;
- b) Sipas rasteve te parashikuara nga Ligji Tregtar;
- c) Me hapjen e procedurave te falimentimit;
- ç) Me vendim te gjykates;

Neni 26

Ne rastin e prishjes se shoqerise, Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar nje ose disa likuidatore.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortaket, duke likuiduar ne radhe te pare detyrimet ndaj punonjesve, shtetit e me pas ndaj te treteve. Ne rastin e teprices se kapitalit te shoqerise me perfundimin e likuidimit, kjo i shperndahet Ortakeve.

Nese Ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

Neni 27

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas vendimit te Asamblese se pergjithshme te Ortakeve , ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare”.

Baza ligjore

Neni 28

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare”, Kodi Civil dhe cfaredo ligji tjeter ne Republiken e Shqiperise.

Neni 29

Mosmarreveshjet qe mund te lindin midis shoqerise dhe te treteve, zgjidhen me mirekuptim, ne te kundert palet i drejtohen Gjykates se Republikes se Shqiperise per zgjidhje.

Neni 30

Ky statut u perpilua ne prani te ortakeve te shoqerise duke shprehur vullnetin e tyre te plete e te lire.

Ai u perpilua ne tre kopje me fuqi te barabarta secila, per t'u depozituar ne QKB, per t'u shperndare ne organet kompetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise.

Tirane me 25/03/2019

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

**“BUILDING 2019” SHPK
Gaetano GIOVANNETTI**

